

Intervista e komandantit të FSK-së, dhënë gazetës ditore “Zëri”

Rama: Për dalje në veri vendos ekzekutivi

Komandanti i FSK-së, Gjenerallejtënant, Rrahman Rama thotë se FSK ka kapacitete të mjaftueshme kadrovike të transformohet në ushtri. Ai, në një intervistë dhënë “Zëri” tha se shkuarja e shkuarja e ushtrisë së ardhshme të vendit në pjesën veriore të Kosovës, varet nga vendimet e Qeverisë, respektivisht të Presidencës së vendit.

Albert Ahmeti / Prishtinë

Qeveria e Kosovës dhe Presidenca do të vendosin nëse ushtria e ardhshme e vendit (Forcat e Armatosura të Kosovës) do të veprojnë edhe në pjesën veriore. Kështu ka deklaruar komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, në një intervistë për gazetën “Zëri”. Ai ka thënë se FSK-ja nuk është mekanizëm që prodhon vendime të tilla, por thjesht i zbaton vendimet që merren nga institucionet përgjegjëse. “Duhet të theksoj se ne nuk prodhojmë urdhra, por i zbatojmë ato. Çdo urdhër dhe çdo detyrë që del nga institucionet përkatëse, në këtë rast nga Qeveria dhe Presidenca, ne do t’i zbatojmë”, është shprehur Rama. Kjo deklaratë e kreut të FSK-së vjen pas debatit që ka ngjallur në shoqërinë kosovare deklarata e kryeministrit, Isa Mustafa, i cili ka thënë se FAK-u do të mundë të shkojë në pjesën veriore të vendit vetëm pasi të marrë leje nga NATO-ja. Madje këtë deklaratë të kryeministrit e pati kundërshtuar edhe vet komandanti i FSK-së, Rrahman Rama duke thënë se ushtria e vendit nuk ka nevojë për leje për të shkuar në veri. Mirëpo këtë herë Rama është shprehur më i kujdesshëm në deklarime rreth kësaj çështje. I pari i FSK-së më tej ka thënë se ky mekanizëm i sigurisë i ka kapacitetet e mjaftueshme kadrovike dhe operacionale për t’u bërë ushtri moderne. Megjithatë sipas tij pjesëtarët e FSK-së do të kalojnë nëpër një vlerësim të përgjithshëm gjatë shndërrimit të FSK-së në FAK.

Zëri: Në çfarë gjendje është sot FSK? A funksionin FSK me standarde të NATO-s?

Rama: FSK-ja është ngritur mbi bazën e standardeve të NATO-s. Ju e dini që në realitet janë vlerësuar dhe janë njoh aftësitë apo kapacitetet e FSK-së e edhe nga NATO. Mendoj që këto aftësi dhe këto kapacitete që i kemi aktualisht janë plotësuar në terren. Kjo dëshmohet edhe me faktin që për çdo ditë jemi edhe në asistencë të qytetarëve por edhe mbahen trajnime profesionale si brenda FSK-së ashtu e dhe jashtë saj. Prandaj gjithçka që ndërtohet këtu, ndërtohet mbi bazën e standardeve të NATO-s.

Zëri: A ka kapacitete të mjaftueshme, kadrovike që FSK të transformohet në FAK?

Rama: Tash e shtatë vjet jemi si Forcë e Sigurisë dhe njëra ndër prioritetet tona ka qenë që ta ngrisim profesionalizimin tonë brenda Forcës dhe falë bashkëpunimit dhe koordinimit që kemi edhe me NATO-n, FSK-ja çdo ditë po profesionalizohet dhe po zhvillohet zhvillohet. Kemi kapacitete kadrovike për transformim në Forcën e Armatosur të Kosovës.

Zëri: A do të ketë ndryshime në strukturën e FA? A do të jenë pjesë e FA, të gjithë pjesëtarët aktual të FSK, apo do të ketë ndryshime?

Rama: Çdo tranzicion i ka edhe ato sfidat e veta. Misioni do të ndryshoj, por natyrisht do të ndryshoj edhe struktura. Të gjithë pjesëtarët e FSK-së do të kenë vend, përveç atyre që e kanë moshën e pensionimit, por do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm dhe në qoftëse ka ndonjë që nuk i plotëson kriteret bazë, atëherë ata nuk do të jenë pjesë e Forcës së Armatosur.

Zëri: A ka FSK akademi ushtarake apo shkollim ushtarak. Mbi çfarë kritere i nxjerrin kuadrot?

Rama: Ne e kemi qendrën universitare, e cila funksionon në bazë të doktrinës dhe standardeve amerikane. Këtë e kemi në funksion për më tepër se 10 vite dhe çdo vit nxjerrim gjenerata të reja të oficerëve të rinj dhe do të vazhdojmë edhe në vitet pasuese. Jemi të kënaqur me performancën dhe angazhimin e tyre që njëkohësisht ne i edukojmë edhe në kuptimin e fakulteteve civile, por njëkohësisht përfundojnë edhe akademinë ushtarake. Kur ata e përfundojnë këtë akademi ne e kemi një marrëveshje me SHBA-të që të bëjmë trajnime shtesë, më të avancuar që t'i përgatisim për oficerë të rinj.

Zëri: A po plakët FSK? Cila është struktura e saj?

Rama: Ata që dalin në pension ne i zëvendësojmë. Tek oficerët, ne prodhojmë oficerë, por njëkohësisht edhe të nënoficerët dhe tek ushtarët ne tash së fundi e kemi pas edhe një kampanjë të suksesshme të rekrutimit. Është nderë për institucionin tonë, por edhe për mua personalisht, gatishmëria e qytetarëve të vendit për të qenë pjesë e FSK-së dhe për një numër të caktuar i kemi pas përafërsisht gjashtë mijë kandidat. E kemi bërë përzgjedhjen mbi bazën e standardeve dhe kritereve dhe tash i kemi në trajnim bazik 156 rekrut të rinj që presim që deri në fund të këtij muaji ta përfundojnë trajnimin bazik dhe të shpërndahen nëpër njësite të caktuara.

Zëri: Sa trupa ushtarake do të jenë të mjaftueshme për Kosovën?

Rama: Ju e dini që është bërë një rishikim i sektorit të sigurisë në nivel të Kosovës dhe duke u bazuar në rekomandimet që kanë dal prej atij procesi, është marrë një vendim nga Qeveria e Kosovës që Forca e Armatosur e Kosovës t'i ketë 5000 mijë ushtarë aktiv dhe 800 rezervë. Ky numër që ka dalë është bazuar në nevojat që mund t'i ketë Kosova duke pas parasysh pozitën gjeografike dhe elementet tjera. Mendoj që ky është një numër i mjaftueshëm.

Zëri: Cilat janë armët me të cilat do të pajiset FA dhe sa i ka mundësitë Kosova që të blej pajisjet e nevojshme?

Rama: I kemi disa pajisje mbi bazën e nevojave aktuale dhe të misionit, duke filluar nga pajisjet individuale, por edhe ato kolektive që ndërliken me edhe me armët. Është bërë një plan i veprimit, ose i zhvillimit të forcës së ardhshme dhe mbi bazën e këtij plani janë paraparë edhe buxheti edhe pajisjet e nevojshme që duhet t'i ketë Forca e Armatosur. Ne do të vazhdojmë ta zbatojmë këtë plan. E kemi përkrahjen nga Qeveria për të gjitha ato nevoja që i kemi gjatë implementimit të këtij plani.

Zëri: A prisni mbështetje edhe nga NATO?

Rama: Ne kemi donacione të ndryshme nga vendet tona mike që si liderë janë SHBA-të. Kemi pas përkrahje edhe nga NATO-ja dhe nga shtete tjera. Do të vazhdojmë koordinimin dhe bashkëpunimin me ta, varësisht nga nevojat që i kemi dhe mundësi që ata i kanë, kështu që të gjitha ato donacione do të jenë të mirëseardhura për neve.

Zëri: Kur do ta shohim FA me pajisje të tilla si helikopterë ushtarak?

Rama: Ne jemi në fazën fillestare, fillimisht duhet të ndryshohen Kushtetuta dhe Ligjet. Dhe siç e thash është edhe një plan i cili ka afate. Nuk mendoj që është ende koha që të flitet tash ende pa fillua të zbatohet ky plan i zhvillimit. Por mendoj që në të ardhmen Kosova do t'i ketë edhe helikopterët edhe të gjitha pajisjet e nevojshme.

Zëri: Brenda sa vitesh prisni që FA do të kompletohet si ushtri?

Rama: në bazë të planit, afati është dhjet vjeçar. Mbi bazën e analizave të përgjithshme dhe me ekspertë nga SHBA-të, ne kemi menduar që të jetë një forcë funksionale dhe operationale në afatin kohor 10 vjeçar, por kjo nuk do të thotë nuk mund ta arrijmë atë standard edhe më herët se dhjetë vite.

Zëri: A do të veprojnë FA edhe në veri të vendit?

Rama: Duhet të theksoj se ne nuk prodhojmë urdhra, por i zbatojmë ato. Çdo urdhër dhe çdo detyrë që del nga institucionet përkatëse, në këtë rast nga Qeveria dhe Presidenca ne do t'i zbatojmë. Nuk kam ndonjë komente tjetër.

Zëri: Kur Kosova të bëhet me ushtri të veten çfarë do të ndodhë me KFOR-in?

Rama: Nuk dua të flas për çështje që nuk më takojnë, sepse është çështje e NATO-s. Por KFOR-i edhe një kohë do të jetë këtu, mirëpo ne e kemi një bashkëpunim dhe koordinim shumë të mirë. Poashtu kemi përkrahje të fuqishme nga ana e KFOR-it në të gjitha aspektet edhe në kuptimin e trajnimit por edhe në koordinimin e aktiviteteve. Por për këtë çështje është dikush tjetër që vendos.

Zëri: A besoni që Kosova do të mund të anëtarësohet në NATO, para këtyre dhjetë viteve që janë paraparë që FA të kompletoj mundësitë operationale?

Rama: E përmenda edhe më herët, ne NATO-n e kemi këtu, jemi bashkërisht dhe gjithë ky proces i madh është bërë në bashkëpunim me NATO-n. Ne absolutisht e kemi bërë hapur me NATO-n dhe i gjithë ky proces do ta ketë finalizimin në NATO. Se kur do të ndodhë kjo, ka ndërlidhje edhe politike, por detyrë jona është që Forca e Armatosur e Kosovës të përgatitet që kur të vijë ai moment, ajo të jetë e gatshme të bëhet pjesë e NATO-s.